



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

**V E N D I M**  
**K.P.P. 527/2018**

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Enkeleda Bega	Nënkryetar
Vilma Zhupaj	Anëtar
Lindita Skeja	Anëtar
Merita Zeqaj	Anëtar

Në mbledhjen e datës 07.08.2018 shqyrtoi ankesën me:

**Objekt:**

Shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë “Eurogjici Security” shpk dhe “Nazeri 2000” shpk në procedurën e prokurimit “Kërkesë për Propozim” me Nr. REF-58553-03-26-2018, me objekt: “Shërbim me roje civile” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj (i ndarë sipas loteve) LOTI I: Objekti “Shërbim me roje civile zyrat e Drejtorisë Rajonit Verior Shkodër dhe zyrat e ish –Sektorit Fushë Arrës në (F.Arrës, Pukë)”, me fond limit 6.124.789 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 24.04.2018, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Rajonit Verior, Shkodër.

Gjithashtu ankimuesi “Trezhnjeva” shpk, kërkon të mbeten të skualifikuar, si dhe ti shtohen arsyet e skualifikimit shoqërive “Toni Security” shpk dhe “Dani Security” shpk në procedurën e mësipërme të prokurimit.

**Autoriteti kontraktor:**

Drejtoria e Rajonit Verior, Shkodër  
Lagjia: “3 Heronjtë”, Rruga: “At Zef Valentini”, Shkodër.

**Ankimues**

“Trezhnjeva” sh.p.k  
Njësia nr.7, ish-Fusha e Aviacionit, Blv i Dafinave  
God.nr.22, Pall nr.2, Kati.3, Ap.9, Tiranë.

**Subjekte të interesuar:**

“Eurogjici Security” sh.p.k.  
Rruga “Adem Jashari”, Lagja nr. 8, H.10, Ap.3, Tiranë.

“Nazeri 2000” shpk  
Rruga e Kavajës, Qendra Condor, Kati II, Tiranë.

**Baza Ligjore:**

Ligji nr. 9643 datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar; Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010, “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes, shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesve, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

**V Ë R E N:****I***Vlerësimi paraprak*

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën. 1, të nenit. 63, të Ligjit Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në Ligjin Nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar.

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

## II

### *Rrethanat e çështjes*

II.1. Në datën 27.03.2018 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit Nr. REF-58553-03-26-2018, me objekt: *“Shërbim me roje civile” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj (i ndarë sipas loteve) LOTI I: Objekti “Shërbim me roje civile zyrat e Drejtorisë Rajonit Verior Shkodër dhe zyrat e ish –Sektorit Fushë Arrës në (F.Arrës, Pukë)”*, me fond limit 6.124.789 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 24.04.2018, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Rajonit Verior, Shkodër.

II.2. Në datën 24.04.2018, autoriteti kontraktor ka zhvilluar procedurën e prokurimit.

Në këtë procedurë prokurimi kanë marrë pjesë operatorët ekonomikë si më poshtë, të cilët referuar dokumentacionit të autoritetit kontraktor, kanë paraqitur ofertat ekonomike si më poshtë:

1. <i>“Toni Security” shpk</i>	5.831.852,90 lekë	<i>skualifikuar</i>
2. <i>“Eurogjici Security” shpk</i>	5.831.852,90 lekë	<i>kualifikuar</i>
3. <i>“Nazeri 2000” shpk</i>	5.831.852,90 lekë	<i>kualifikuar</i>
4. <i>“Trezhnjeva” shpk</i>	5.831.852,90 lekë	<i>kualifikuar</i>
5. <i>“Dani Security” shpk</i>	5.831.940,80 lekë	<i>skualifikuar</i>

II.3. Në datën 08.05.2018 operatori ekonomik *“Trezhnjeva” shpk* është njoftuar elektronikisht për klasifikimin dhe kualifikimin e ofertave në këtë procedurë prokurimi.

II.4. Në datën 09.05.2018, operatori ekonomik *“Trezhnjeva” shpk* ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor ku kërkon shfuqizimin e vendimit të KVO-së lidhur me kualifikimin e operatorëve ekonomikë *“Eurogjici Security” shpk* dhe *“Nazeri 2000” shpk*, duke pretenduar skualifikimin e tyre, si dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit dhe mbetjen të skualifikuar të operatorëve ekonomik *“Toni Security” shpk*, dhe *“Dani Security” shpk*, në këtë procedurë prokurimi me pretendimet si më poshtë vijon:

*Në bazë të nenit 63/6, të Ligjit nr. 9643, “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, po paraqesim këtë ankim, duke parashtruar si vijon:*

*Kërkojmë skualifikimin e firmës “Eurogjici Security” shpk.*

*Në dokumentat e tenderit është kërkuar: “Licensë për ngritje dhe shfrytëzim sistemi të pavarur radiokomunikacioni dhe radioalarmi, lëshuar nga AKEP, zonë në të cilin kryhet shërbimi i ruajtjes së objektit, konform Ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008.”.*

*Dokumentacioni i paraqitur prej tij, autorizimi individual me zonë mbulimi Qarku Shkodër 35 km, referuar vendit të instalimit, distanca në kilometra e përcaktuar në autorizimin individual përkatëse, nuk mbulon dhe nuk përfshin në frekuencë distancën reale të vendrojes Fushë-Arrëz.*

*Kërkojmë skualifikimin e firmës "Nazeri2000" shpk, pasi nuk nuk plotëson kërkesat si më poshtë: Nuk plotëson kërkesat dhe kriteret e përcaktuara në dokumentat e tenderit tek Shtojca 1.*

*Firma “Nazeri 2000” shpk nuk plotëson kërkesën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor, sipas pikes 2, të DST, pasi nuk ka paraqitur preventivin për 1 vendroje me 4.98 roje/muaj, kriter i përcaktuar nga autoriteti kontraktor ku detyron ofertuesit që për tu kualifikuar, bashkëlidhur formularit të çmimit të ofertës të paraqitet preventivi për një roje dhe 1 vendroje me 3 turne (4.98 roje) në muai, sipas tabelës dhe përcaktimeve në dokumentat e procedurës së prokurimit.*

*Çertifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën 10 punonjës shërbimi të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut, Shkodër (përfshijtur titullarin dhe drejtuesin teknik).*

*Nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit, Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë, pika 3, në dokumentat e tenderit, pasi nuk ka paraqitur 10 çertifikata të vlefshme të lëshuara nga Drejtoria e Policisë Qarkut, Shkodër brenda afatit 4-vjeçar të vlefshmërisë, të parashikuar në nenin 5, pika 5, të Ligjit Nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike".*

*Kërkojmë të mbetet i skualifikuar firma “Toni Security” shpk dhe arsyeve të skualifikimit ti shtohet arsyeja se: Nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit, Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë pika 3, në dokumentat e tenderit, pasi nuk ka paraqitur 10 çertifikata të vlefshme të lëshuara nga Drejtoria e Policisë Qarkut, Shkodër brenda afatit 4-vjeçar të vlefshëmrisë, të parashikuar në nenin 5, pika 5, të Ligjit Nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike".*

*Kërkojmë të mbetet i skualifikuar firma “Dani Security” shpk dhe arsyeve të skualifikimit ti shtohet arsyeja se:*

*Nuk ka paraqitur sipas përcaktimit të V.K.M-së, vërtetim që konfirmon shlyerjen e të gjitha detyrimeve të maturuara të energjisë elektrike, të kontratave të energjisë që ka operatori ekonomik që është i regjistruar në Shqipëri.*

*Nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit, Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë pika 3, në dokumentat e tenderit, pasi nuk ka paraqitur 10 çertifikata të vlefshme të lëshuara nga*

*Drejtoria e Policisë Qarkut, Shkodër brenda afatit 4-vjeçar të vlefshëmrisë të parashikuar në nenin 5, pika 5, të Ligjit Nr. 75/2014 "Për shërbimin privat të sigurisë fizike".*

*Nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit: "Licensë për ngritje dhe shfrytëzim sistemi të pavarur radiokomunikacioni dhe radioalarmi, lëshuar nga AKEP, zonë në të cilin kryhet shërbimi i ruajtjes së objektit Shkodër, Fushë Arrës, konform Ligjit Nr.9918 datë 19.05.2008.*

*Nuk plotëson kërkesën e përcaktuar nga autoriteti kontraktor, sipas pikës 2, të dokumentave të tenderit, pasi nuk ka paraqitur preventivin për 1 vëndroje me 4.98 roje/muaj, kriter i përcaktuar nga autoriteti kontraktor ku detyron ofertuesit që për tu kualifikuar bashkëlidhur formularit të çmimit të ofertës të paraqitet preventivi për një roje dhe 1 vëndroje me 3 turne (4.98 roje) në muai, sipas tabelës dhe përcaktimeve në dokumentat e procedurës së prokurimit.*

*Si përfundim kërkohet:*

*Së pari: Marrjen parasysh të ankesës tonë.*

*Së dyti: Pezullimin e procedurës deri në shqyrtim të plotë të ankesës tonë.*

*Së treti: Skualifikimin e firmes "Eurogjici Security" shpk, "Nazeri 2000" shpk për arsye të mësipërme, mbetjen të skualifikuar dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit për "Toni Security" shpk, "Dani Security" shpk për arsye të mësipërme.*

II.5. Në datën 16.05.2018, me shkresën nr. 202 prot, shoqëria "Trezhnjeva" shpk është vënë në dijeni në lidhje me mospranimin e ankesës së paraqitur prej tij nga autoriteti kontraktor.

II.6. Në datën 21.05.2018, pala ankimuese operatori ekonomik "Trezhnjeva" shpk ka dorëzuar ankesë pranë Komisionit të Prokurimit Publik, duke parashtruar të njëjtat pretendime që kishte parashtruar tek autoriteti kontraktor.

II.7. Me shkresën me nr. 218 prot, datë 28.05.2018, protokolluar me tonën me nr. prot. 948/2 datë 04.06.2018, me objekt "Kthim përgjigje" është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni dhe dokumentacioni i autoritetit kontraktor lidhur me procedurën e mësipërme të prokurimit dhe trajtimin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

### **III**

#### **Komisioni i Prokurimit Publik**

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumenteve të dërguara nga autoriteti kontraktor,

**Arsyeton**

III.1. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Trezhnjeva” shpk, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së paraqitur prej operatorit ekonomik “Eurogjici Security” shpk me arsyen se: “Në dokumentat e tenderit është kërkuar: “Licensë për ngritje dhe shfrytëzim sistemi të pavarur radiokomunikacioni dhe radioalarmi, lëshuar nga AKEP, zonë në të cilin kryhet shërbimi i ruajtjes së objektit, konform Ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008.”.

Dokumentacioni i paraqitur prej tij, autorizimi individual me zonë mbulimi Qarku Shkodër 35 km, referuar vendit të instalimit, distanca në kilometra e përcaktuar në autorizimin individual përkatëse, nuk mbulon dhe nuk përfshin në frekuencë distancën reale të vendrojes Fushë-Arrëz.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në Shtojcën.7, “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit” “Kapaciteti teknik”, pika 2 të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi përcaktohet kriteri si më poshtë:

“Autorizim Individual për operatorin ofertues, lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare për “Radiokomunikim”, konform ligjit nr. 9918 datë 19.05.2008, ku të përfshihet qyteti i Shkodrës”.

III.1.2. Në shtojcën.11 “Shërbimet dhe grafiku i shërbimit” të dokumentave të procedurës së prokurimit objekt ankimi, përcaktohen elementët e shërbimit si më poshtë:

**“Shërbimi që kërkohet: Objekti: “Shërbim me roje civile” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj. (I ndarë sipas loteve)**

**LOTI I: Objekti “Shërbim me roje civile zyrat e Drejtorisë Rajonit Verior, Shkodër dhe zyrat e ish –Sektorit Fushë Arrës në (F.Arres, Pukë).”.**

III.1.3. Nga verifikimet e kryera në Sistemin e Prokurimeve Elektronike (S.P.E.) për plotësimin e kriterit të mësipërm, operatori ekonomik “Eurogjici Security” shpk, ka dorëzuar dokumentacionin si më poshtë vijon:

“Autorizim Individual” nr. AI-U1396, lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare (AKEP), më datë 27.11.2014, në emër të shoqërisë “Eurogjici Security” shpk; Aneks N<sup>o</sup>2/1 (AKEP-2014-AI-U1396-1-46) “Për caktim dhe përdorim frekuencash në brezat VHF, UHF, sisteme radiokomunikimi”, me stacionin bazë të instaluar në lagjia “Vasil Shanto” dhe stacionin përsëritës në Plan Gjuraj, Majë e Madhe, me zonë ofrimi shërbimi për sisteme radiokomunikimi Qarku Shkodër – 35 km, me kohë përdorimi të frekuencava nga 27.11.2014-31.12.2020.

III.1.4. Në nenin 46, pika 1, të ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se: “Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti

*kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese.”*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcaktohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.1.5. Në nenin 28 pika 5 të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht: “Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

*“a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose[...].”*

III.1.6. Në nenin 66, të ligjit nr. 9918, datë 19.05.2008 *“Për komunikimet elektronike në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, përcaktohet shprehimisht se: “AKEP-i lëshon një autorizim individual për përdorimin e frekuencave, në përputhje me PKRF-në dhe Planin e Përdorimit të Frekuencave , për caktimin dhe përdorimin e frekuencave sipas neneve 62, 63, 64, 65, 66, 67, 68, 69, 70 dhe 71 të këtij ligji.”*

Në këto autorizime, përcaktohet edhe zona e mbulimit (neni 70, pika 1, e Ligjit të lartpërmendur), ku përcaktohet se: *“Autorizimi individual për përdorimin e frekuencave përmban: a) të dhëna për përfituesin; b)frekuencat e përfituara ; c) vendndodhjen dhe zonën e mbulimit; ç) afatin e vlefshmërisë së autorizimit; d) kushtet, që duhet të përmbushen për shfrytëzimin e frekuencës së caktuar, sipas nenit 71 të këtij ligji”.*

III.1.7. Kriteret për kualifikim vendosen që t’i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t’u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentat e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumenta duhet të refuzohen si të papranueshme. Në mbështetje të pikës 3, të nenit 66, të VKM nr. 914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, në të cilën përcaktohet se komisioni verifikon dhe vlerëson ofertat e dorëzuara, duke kualifikuar vetëm ato oferta, që përmbushin kriteret për kualifikim, të përcaktuara në dokumentat e tenderit.*

III.1.8. Referuar dokumentacionit të dorëzuar nga operatori ekonomik *“Eurogjici Security”* shpk Komisioni gjykon se operatori në fjalë me anë të dokumentacionit të paraqitur dëshmon se disponon autorizim lëshuar nga Autoriteti i Komunikimeve Elektronike dhe Postare, ku periudha e vlefshmërisë së autorizimit mbulon periudhën kohore në të cilën është parashikuar të kryhet

zbatimi i kontratës. Referuar skemës së organizimit të shërbimit me sisteme radiokomunikimi, KPP gjykon se operatori ekonomik nuk plotëson kriterin e përcaktuar në dokumentat e tenderit nga ana e autoritetit kontraktor, pasi në autorizimin individual të paraqitur nuk përfshihet zona ku do të kryhet shërbimi i kërkuar.

Akoma më tej lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimes “Trezhnjeva” shpk, mbi ofertën e shoqërisë “Eurogjici Security” shpk me arsyen se: *“Licensë për ngritje dhe shfrytëzim sistemi të pavarur radioalarmi, lëshuar nga AKEP, zonë në të cilin kryhet shërbimi i ruajtjes së objektit, konform Ligjit Nr.9918, datë 19.05.2008.”.*

*Dokumentacioni i paraqitur prej tij, autorizimi individual me zonë mbulimi Qarku Shkodër 35 km, referuar vendit të instalimit, distanca në kilometra e përcaktuar në autorizimin individual përkatëse, nuk mbulon dhe nuk përfshin në frekuencë distancën reale të vendrojes Fushë-Arrëz. [...]*, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, ky është një kriter i pakërkuar nga autoriteti kontraktor në dokumentat e tenderit të procedurës së prokurimit.

Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, operatori ekonomik “Eurogjici Security” shpk nuk e ka përmbushur kriterin e kualifikimit, të kërkuar në dokumentat e tenderit nga autoriteti kontraktor.

Përsa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “Trezhnjeva” shpk qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “Trezhnjeva” shpk, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së paraqitur prej operatorit ekonomik “Nazeri 2000” shpk me arsyen se: *“Çertifikata për punonjës shërbimi në fushën e veprimtarisë së shërbimit për ruajtjen dhe sigurimin fizik të objekteve dhe pronave për të paktën 10 punonjës shërbimi të lëshuara nga Drejtoria e Policisë e Qarkut, Shkodër (përfshijë titullarin dhe drejtuesin teknik).*

*Nuk plotëson kriteret e veçanta të kualifikimit, Kapaciteti ligjor i operatorëve ekonomikë, pika 3, në dokumentat e tenderit, pasi nuk ka paraqitur 10 çertifikata të vlefshme të lëshuara nga Drejtoria e Policisë Qarkut, Shkodër brenda afatit 4-vjeçar të vlefshmërisë, të parashikuar në nenin 5, pika 5, të Ligjit Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:*

III.2.1. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 7, *“Kriteret e veçanta të kualifikimit”*, pika 4 *“Kapaciteti teknik”*, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar se: *“Operatori Ekonomik duhet të dorëzojë 10 Çertifikata për ushtrim profesioni lëshuar nga DVP Shkodër”.*

Ndërsa po në Shtojcën 7, *“Kriteret e veçanta të kualifikimit”*, pika 3 *“Kapaciteti teknik”* nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar se operatori ekonomik duhet të paraqesë: *“Subjekti SHPSF duhet të paraqesë Vërtetim/Preformance nga Drejtoria Vendore e Policisë së Qarkut Shkodër, të lëshuar jo më parë se tre muaj nga dita e hapjes së ofertave nëpërmjet të cilit të jepet informacioni mbi:*



*numrin e punonjësve të shërbimit të çertifikuar, jo më pak se 10 (dhjetë) të ketë qëndër të kontrollit të shërbimeve në Qarkun e Shkodrës.”.*

III.2.2. Nga verifikimet në sistemin e prokurimeve elektronike, rezulton se operatori ekonomik “Nazeri 2000” shpk, në përmbushje të kriterit të mësipërm, ka paraqitur dokumentacionin si më poshtë:

*Vërtetim Nr. 785/1 prot, datë 08.02.2018, për operatorin ekonomik “Nazeri 2000” shpk lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë, Shkodër, ku numri i punonjësve të shërbimit gjithsej është 23 punonjës, si dhe 15 çertifikatat punonjësish shërbimi dhe konkretisht: S.H me numër çertifikate 001086 datë 27.05.2014, M.K me numër çertifikate 000560 datë 15.02.2011, F.ZH me numër çertifikate 000645 datë 14.04.2011, K.ZH me numër çertifikate 0726 datë 18.11.2011, P.N me numër çertifikate 0135 datë 20.05.2010, S.M me numër çertifikate 000119 datë 09.05.2010, S.K me numër çertifikate 001005 datë 03.09.2013, K.S me numër çertifikate 0702 datë 26.09.2011, L.P me numër çertifikate 000783 datë 20.05.2012, A.L me numër çertifikate 000777 datë 20.01.2012, A.A me numër çertifikate 000701 datë 25.11.2013, I.S me numër çertifikate 000705 datë 26.02.2013, Q.M me numër çertifikate 001235 datë 24.11.2014, L.S me numër çertifikate 032 datë 28.05.2015 dhe B.D me numër çertifikate 1288 datë 11.03.2015, nga të cilat 4 çertifikata janë të vlefshme brenda afatit 4 vjeçar.*

III.2.3. Në dokumentat e tenderit, Shtojca 11, “Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit”, nga ana e autoritetit kontraktor është përcaktuar se:

### **Shtojca 11**

#### **SHËRBIMET DHE GRAFIKU I EKZEKUTIMIT**

**Shërbimi që kërkohet:Objekti: “Shërbim me roje civile” – Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj.**

**(I ndarë sipas loteve)**

**LOTI I:** Objekti “Shërbim me roje civile zyrat e Drejtorisë Rajonit Verior Shkodër dhe zyrat e ish –Sektorit Fushë Arrës në (F.Arrës, Pukë).

**LOTI II:** Objekti “Shërbim me roje civile Zyrat e Sektorit Kukës dhe Skrapin në Trull Surroi (Kukës).

**Afatet e ekzekutimit: 12 muaj ( i parashikuar)**

#### **Vendndodhja e shërbimit:**

<i>Numri i Vendrojeve</i>	<i>Numri i turneve</i>	<i>Numri i rojeve të nevojshme</i>	<i>Afati i lëvrim</i>
<b>4</b>	<b>3</b>	<b>4.98</b>	<b>12 muaj</b> <i>Kontratat do të jepen nga momenti i lidhjes së Marrveshjes Kuadër me OE</i>

			shpallur fitues nga kjo procedurë prokurimi, sipas përcaktimit të AK me afat përfundimtar 12 muaj.
--	--	--	--

III.2.4. Në nenin 46, pika 1, të Ligjit nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: *“Operatorët ekonomikë, për të marrë pjesë në procedurat e prokurimit, duhet të kualifikohen, pasi të kenë përmbushur të gjitha kriteret që autoriteti kontraktor i vlerëson të nevojshme, për sa kohë që ato janë në përpjestim me natyrën dhe përmasat e kontratës që do të prokurohen dhe jodiskriminuese”.*

Ndërsa në nenin 53/3 të LPP-së përcakohet se: *“Autoriteti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një oferte të vlefshme, vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentat e tenderit.”*

III.2.5. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, neni 28, pika 5, parashikohet si më poshtë: *“Për të provuar kapacitetet teknike dhe profesionale, autoriteti kontraktor kërkon:*

*a) licencat profesionale për realizimin e shërbimeve, objekt i kontratës, të lëshuara nga autoritetet kompetente shtetërore; dhe /ose*

*b) një listë të personelit kryesor, të nevojshëm për të zbatuar objektin e prokurimit dhe/ose komponentët e saj. Lista e personelit kryesor duhet të përfshijë CV-të e tyre dhe licencat profesionale, kur kanë të tilla; dhe/ose*

*c) dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik të nevojshëm për ekzekutimin e objektit të prokurimit; dhe/ose*

*ç) dëshmi për mjetet dhe pajisjet teknike që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.*

III.2.6. Neni 5 i Ligjit Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike” parashikon shprehimisht se:

*1. Certifikimi i titullarit dhe i drejtuesit teknik të SHPSF-së është kompetencë e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit.*

*2. Certifikimi i punonjësit të shërbimit është kompetencë e drejtorit të policisë së qarkut.*

*3. Vendimet e certifikimit, sipas përcaktimeve në pikat 1 dhe 2, të këtij neni, lëshohen duke u bazuar respektivisht në mendimin paraprak të KSHKCL-së dhe KSHKC-së.*

*4. Pajisja me certifikatë e titullarit të subjektit dhe drejtuesit teknik bëhet brenda 45 ditëve, ndërsa për punonjësin e shërbimit bëhet brenda 30 ditëve nga dita e plotësimit të formularit të kërkesës për aplikim.*

*5. Certifikata është e vlefshme për 4 vjet me të drejtë ripërtëritjeje, për titullarin e subjektit, për drejtuesin teknik dhe punonjësin e shërbimit.*

III.2.7. Referuar legjisllacionit në fuqi për prokurimin publik, vendosja e kriterëve të veçanta për kualifikim ka si synim kryesor që t'i shërbejë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe

kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës në respekt të nenit 46 pika 1 gërma “b”, të Ligjit Nr.9643 dt.20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, i cili parashikon se: “[...] aftësia teknike: operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës [...]”.

III.2.8. Në rekomandimin e përbashkët ndërmjet Komisionit të Prokurimit Publik dhe Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit për shërbimin privat të ruajtjes fizike”, i datës 20.12.2017, publikuar në faqen zyrtare të KPP, në pikën 2, paragrafi 7, është parashikuar shprehimisht: *“Në lidhje me hartimin e kriterit për paraqitjen e certifikatave të punonjësve të shërbimit, në kushtet kur, procesi i ricertifikimit të punonjësve të shërbimit nuk ka përfunduar ende dhe është në proces për një afat të pacaktuar, kjo sipas informacionit të dhënë nga Drejtoria e Policisë së Shtetit, autoritetet kontraktore rekomandohen si më poshtë vijon: Në rastet kur, në dokumentat e tenderit do të kërkohet paraqitja e certifikatave të punonjësve të shërbimit, së bashku me këtë kriter rekomandojmë që, të kërkohet edhe paraqitja e një vërtetimi të lëshuar nga Drejtoria e Policisë Vendore, i cili duhet të përmbajë të dhëna për listën emërore të punonjësve të shërbimit të certifikuar, dhe vlefshmërinë e këtyre certifikatave, datën e certifikimit (datën e lëshimit), si dhe afatin e vlefshmërisë së kësaj certifikate.”*

III.2.9. Në korrespondencën e Komisionit të Prokurimit Publik me Drejtorinë Vendore të Policisë Tiranë, në lidhje me vlefshmërinë e certifikatave, kjo e fundit citon se: *“Cilësimi i (vlefshëm) në vërtetimet e performancave për punonjës të certifikuar të cilëve sipas ligjit actual i ka përfunduar afati 4 vjeçar, është bërë për shkak të vakumit ligjor të krijuar nga anulimi i udhëzimit 308, datë 22.05.2017 “Për funksionin e shërbimit privat të sigurisë fizike dhe Qendrës së Trajnimit Privat të punonjësve të SHPSF-ve” si dhe akteve ligjore e nënligjore për zbatimin e ligjit 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”. Mungesa e bazës ligjore pezulloi përkohësisht procesin e certifikimit të aplikantëve për shpsf-t, dhe qëllimi i cilësimit i “vlefshëm” ishte shmangia nga penaliteti i punonjësve të cilët sipas ligjit actual paisen me certifikatat me afat 4 –vjeçar.*

*Bazuar në nenin 5 të ligjit 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, dhe Udhëzimit të Ministrisë të Brendshme nr. 130, datë 05.03.2018 “Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike”, afati i vlefshmërisë së certifikatave të punonjësve të shërbimit, shpsf, është 4 vjeçar nga momenti i certifikimit të tyre”.*

III.2.10. Lidhur me pretendimet e operatorit ekonomik ankimues “*Trezhnjeva*” shpk., mbi skualifikimin e ofertës së operatorit ekonomik “*Nazeri 2000*” shpk, KPP konstaton se ky i fundit ka paraqitur një numër të konsiderueshëm certifikata të punonjësve të shërbimit për ruajtjen dhe sigurinë fizike lëshuar nga DVP Shkodër, prej të cilave vetëm 4 prej tyre janë brenda afatit 4-vjeçar të vlefshmërisë të parashikuar në nenin 5, pika 5, të Ligjit Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, si edhe bazuar në shkresën e Drejtorisë Vendore të Policisë Tiranë.

Komisioni vëren se në asnjë dispozitë ligjore apo akt nënligjor nuk parashikohet se certifikatat për punonjësit e shërbimit janë me afat të pacaktuar, përkundrazi për afatin e vlefshmërisë së tyre, pika 5 e nenit 5 të ligjit Nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, parashikon se certifikatat lëshohen për një afat 4-vjeçar me të drejtë ripërtëritje. Edhe vetë Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, me tagrat e organit kompetent dhe përgjegjës për certifikimin e punonjësve të shërbimit të shoqërive shpsf, sqaron në kthimin e përgjigjes drejtuar Komisionit të Prokurimit Publik nëpërmjet shkresës me nr. 4039/1 prot., datë 27.04.2018, se afati i vlefshmërisë së certifikatave të punonjësve të shërbimit shpsf, është 4 vjeçar, nga momenti i certifikimit.

APP e KPP në Rekomandimin e përbashkët, nr.15166 prot e nr.1858 prot, datë 20.12.2017 rekomandojnë se, në rastet kur në dokumentat e tenderit do të kërkohet paraqitja e certifikatave të punonjësve të shërbimit, së bashku me këtë kriter, të kërkohet edhe paraqitja e një vërtetimi të lëshuar nga Drejtoria e Policisë Vendore, i cili duhet të përmbajë të dhëna për listën emërore të punonjësve të shërbimit të certifikuar, dhe vlefshmërinë e këtyre certifikatave, datën e certifikimit (datën e lëshimit), si dhe afatin e vlefshmërisë së kësaj certifikate. Sa më sipër, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se në shkresën nr. 785/1 Prot., datë 08.02.2018, lëshuar nga Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër, ku vërtetohet performanca e veprimtarisë së SHPSF “*Nazeri 2000*” shpk, Drejtoria Vendore e Policisë Shkodër nuk ka përcaktuar afat vlefshmërie të certifikatave të punonjësve të shërbimit të listuar në këtë shkresë (vërtetim), por është shprehur se “[...] *Punonjësit e shërbimit të paisur me certifikata të vlefshme nga ana jonë janë:*”, si dhe ka pasqyruar vetëm gjeneralitetet e punonjësve të shërbimit.

Nga ana tjetër, Drejtoria Vendore e Policisë Tiranë, siç cituam edhe më sipër, sqaron më së miri në lidhje me afatin e vlefshmërisë së këtyre certifikatave në korrespondencën zyrtare me Komisionin e Prokurimit Publik.

Në këto kushte, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, operatori ekonomik “*Nazeri 2000*” shpk, nuk e përmbush kriterin e përcaktuar në shtojcën 7, kapaciteti ligjor dhe teknik të dokumentave të tenderit, të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi, pasi nuk ka paraqitur numrin e kërkuar të certifikatave të vlefshme për punonjësit e shërbimit, të cilat të rezultojnë të pasqyruara edhe në vërtetim, në përputhje me numrin e certifikatave të vlefshme për punonjësit e shërbimit të kërkuara nga autoriteti kontraktor në kriteret e veçanata për kualifikim.

Sa më sipër, pretendimi i operatorit ekonomik “*Trezhnjeva*” shpk qëndron.

III.3. Lidhur me pretendimin tjetër të operatorit ekonomik ankimues “*Trezhnjeva*” shpk, mbi kundërshtimin e kualifikimit të ofertës së paraqitur prej operatorit ekonomik “*Nazeri 2000*” shpk,

si dhe skualifikimin e tij nga procedura e mësipërme e prokurimit, Komisioni i Prokurimit Publik, gjykon se nuk ka ndikim mbi fatin e çështjes, tashmë që i është pranuar njëri prej pretendimeve të tij dhe gjendja faktike dhe juridike e këtij operatori do të ndryshojë, duke u skualifikuar nga procedura e prokurimit në fjalë, e për rrjedhojë duke përmbushur interesin e ankimuesit, ndaj edhe nuk do të merret në shqyrtim, për ekonomi të procedurës administrative.

III.4. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik “*Trezhnjeva*” shpk, mbi mbetjen të skualifikuar, si dhe shtimin e arsyeve të skualifikimit për ofertën e paraqitur nga operatorët ekonomikë “*Toni Security*” shpk dhe “*Dani Security*” shpk, Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se, fati i këtyre shoqërive është përcaktuar tashmë prej vendimit të KVO-së të datës 08.05.2018, ku këto shoqëri rezultojnë të skualifikuar nga kjo procedurë prokurimi, e për rrjedhojë pa asnjë ndikim në interesat e ankimuesit. Për më tepër, nga verifikimi i informacionit të paraqitur nga autoriteti kontraktor, si dhe nga shqyrtimi administrativ në KPP, nuk rezulton që këta operatorë ekonomikë të jetë ankimuar në lidhje me këtë procedurë prokurimi.

Rrjedhimisht, pretendimi i operatorit ekonomik “*Trezhnjeva*” shpk mbi shoqëritë “*Toni Security*” shpk dhe “*Dani Security*” shpk nuk do të merren në shqyrtim.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “*Për Prokurimin Publik*”, të ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr. 184, datë 17.03.2010 “*Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”*”, të ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

#### **Vendos:**

1. Të pranojë ankesën e operatorit ekonomik “*Trezhnjeva*” shpk për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për Propozim*” me Nr. REF-58553-03-26-2018, me objekt: “*Shërbim me roje civile*” – *Marrëveshje Kuadër - me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 12 muaj (i ndarë sipas loteve) LOTI I: Objekti “Shërbim me roje civile zyrat e Drejtorisë Rajonit Verior Shkodër dhe zyrat e ish –Sektorit Fushë Arrës në (F.Arrës, Pukë)”*, me fond limit 6.124.789 lekë pa tvsh, zhvilluar më datë 24.04.2018, nga autoriteti kontraktor Drejtoria e Rajonit Verior, Shkodër.
2. Të anulojë vendimin e KVO-së mbi kualifikimin e operatorëve ekonomikë “*Eurogjici Security*” shpk, “*Nazeri 2000*” shpk dhe të korrigjojë shkeljet, duke i skualifikuar këta operatorë ekonomikë.
3. Autoriteti kontraktor brenda 10 ditëve të vëre në dijeni Komisionin e Prokurimit Publik për zbatimin e vendimit, duke dokumentuar veprimet e kryera.

4. Ngarkohet zyra e financës të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik “*Trezhnjeva*” shpk.

5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

**Nr. 949 Protokolli;**

**Datë 21.05.2018**

### **KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK**

**Nënkryetar  
Enkeleda Bega**

**Anëtar  
Vilma Zhupaj**

**Anëtar  
Lindita Skeja**

**Anëtar  
Merita Zeqaj**

**Kryetar  
Evis Shurdha**